

SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI

**“REHABILITIMI I REZERVUARIT QILARISHT”
NJESIA ADMINISTRATIVE PETRAN
BASHKIA PERMET
QARKU GJIROKASTER**

“BEJ-74” sh.p.k. - Tirane

PARAQITJE E PERGJITHSHME

Keto "Specifikime Teknike", jane nje dokument hartuar enkas nga "BEJ-74" SHPK, per realizimin e projektit te: "**Rehabilitimi i rezervuarit te Qilarishtit**", njesia administrative **Petran, Bashkia Permet**

Ky dokument te konsiderohet si pjese perberese e Dokumentacionit te Projektit Zbatimit dhe Preventivit Perfundimtar per objektin e mesiperm.

Kapitujt dhe Zerat e rradhitur ne permbajtje te ketyre specifikimeve teknike jane pjese dhe pershkrim i detajuar i vizatimeve te "BEJ-74" SHPK, si dhe specifikime te tjera te mundshme te kategorive te ndryshme te punimeve ndertimore.

Kontraktoret e Punimeve te Ndertimit duhet t'u referohen specifikimeve teknike te atyre zerave te punimeve te cilat perfshihen ne pershkrimet e Vizatimeve, ne Preventivin Perfundimtar si dhe ne Pershkrimin e Punimeve.

Standartet e perdorura ne keto "Specifikime Teknike" dhe qe do te aplikohen me tej nuk mbesh teten vetem ne vizatimet, por edhe ne manualet ligjore dhe libra te tjere keshillues

LEGIENDA:

V.T.:	<i>Vizatime Teknike</i>
P.P.:	<i>Pershkrimi i Punimeve</i>
S.T.:	<i>Specifikime Teknike</i>

SHENIM:

Gjate zbatimit te punimeve per rehabilitimin e ketij objekti do te evidentohen probleme te pa parashikuar ne projekt, te vihet ne dijeni projektuesi "BEJ-74" SHPK.

A.1 Punime Skarifikimi

A.1.1. Prerje e bime te vogla Ø-10mm (me nr analize 3.2)

Ne kete ze perfshihet prerja e bimesise sipas siperfaqes se percaktuar ne projektin e zbatimit, ngarkimin e materialeve, transportin dhe shkarkimin ne destinacionin e percaktuar nga bashkia Permet.

A.1.2. Prerje e sistemim pemesh ø 10 - 20 cm (me nr analize 3.3).

Ne kete ze perfshihet prerja, sistemimi i pemeve me diameter Ø 10-20cm, ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e tyre ne destinacionin e percaktuar nga bashkia Permet.

A.1.3. Shkulje e rrenjeve te bimeve te vogla (me nr analize 3.7)

Ne kete ze perfshihet shkulja e rrenjeve te bimeve te vogla, sistemimi, ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e tyre ne destinacionin e percaktuar nga bashkia Permet.

A.2 Punime dheu

A.2.1. Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk ne mjet (bjefi i siperm pjesa e kalldremit) me nr analize 3.106/a

Germim dhe rrafshim dheu, i kryer me mjet mekanik, ne truall te çfaredo natyre dhe konsistence, i thare ose i lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rere, zhavorr, gure etj.), duke perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trungjeve, gureve dhe pjeseve me volum deri ne 0,30 m³, duke perfshire ngarkimin ne mjet.

A.2.2 Rafshim skarpate me krahe ne germim toke e zakonshme(bjefi i siperm) me nr analize 3.48/b

Rafshim skarpate me krahe ne toke te zakonshme ku kosiston germimi, (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rere, zhavorr, gure etj.), duke perfshire ngarkimin ne mjet.

A.2.3. Rafshim skarpate me krahe ne germim toke e zakonshme(bjefi i poshtem) me nr analize 3.48/b

Rafshim skarpate me krahe ne toke te zakonshme ku kosiston germimi, (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rere, zhavorr, gure etj.), duke perfshire ngarkimin ne mjet

A.2.4. Germim themel i vecuar, gropa me sip.10-30 m², ne toke te bute me h = 1.5 m me nr analize 3.59/a

Germim me krahe i kryer per shbllokimin e pusetes vertikale te vepres se marrjes fundore ne anen e brendshme te rezervuarit ngarkimi ne mjet largimi i tyre

A2.5 Transport dheu me auto deri 4.0 km (me nr analize 3.158/4a)

Perfshihen punimet per transportin e argjiles nga vendi i ngarkimit rreth 4km deri ne kantier (dige) dhe shkarkimin ne vendgrumbullimin e percaktuar nga bashkia .

A.3. Punime shtresash

A3.1. Shtrese çakelli kave t=15cm, perhapur e ngjeshur e ngjeshur me tokmak (bjefi I siperm kalldremi) me nr analize 3.210

Perfshihen punimet per transportin ngarkimin dhe shkarkimin ne kantier, perhapjen dhe ngjeshjen e saj me tokmak per 1m² siperfaqe qe shtrihet ne pjesen e sipërme te bjefit .

A3.2. Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri (me nr analize 3.211) kurora e diges

Perfshihen punimet per transportin ngarkimin dhe shkarkimin e gurit ne kantier, sistemimin perpunimin e tij vendosjen ne veper sipas skices per 1m²

A3.3. Shtresë rere natyrore mbi kalldrimin per fiksimin e gureve kaldremit (me nr analize 3.182/b)

Perfshihen punimet per transportin ngarkimin dhe shkarkimin e gurit ne kantier, sistemimin perpunimin e tij vendosjen ne veper sipas skices per 1m²

A3.4. Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri (me nr analize 3.211) poshte shtreses se betonit te shkarkuesit

Perfshihen punimet e blerjes se cakellit, ngarkimin, transportin, shkarkimin ne kantier(rruge), perhapjen dhe ngjeshjen e saj me makineri per 1m² .

A.4. Punime betoni dhe betonarme

Markat e betonit

Raportet e meposhtme per betonin, perdorur ne punimet e ndertimit dhe referuar zerave specifike, jane te vleshme per 1(nje) m³ volum beton me çimento te zakonshme Portland. Keto standarte bazohen ne broshuren "Projektimi i Betoneve te Zakonshme, K.T. 37-75", date Tirane - 1980 (Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimeve I.S.P.Nr. 1).

3.1.1. Beton marka 100 me zhavorr natyror:

Çimento 300 kg 240 , zhavorr m³ 1,05 , uje m³ 0,19.

3.1.2. Beton marka 100 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:

Çimento 300 kg 240 , rere e lare m³ 0,45 , granil m³ 0,70 , uje m³ 0,18.

3.1.3. Beton marka 150 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:

Çimento 400 kg 260 , rere e lare m³ 0,44 , granil m³ 0,70, uje m³ 0,18.

3.1.4. Beton marka 200 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:

Çimento 400 kg 300 , rere e lare m³ 0,43 , granil m³ 0,69 , uje m³ 0,18.

3.1.5. Beton marka 300 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:

Çimento 400 kg 370 , rere e lare m³ 0,43, granil m³ 0,69 , uje m³ 0,185.

Per betonin marka 300, do te perdoret Çimento antisulfate sipas projektit konstruktiv shih V.T.

A4.1. Struktura monolite betoni C 20/25 shkarkuesi katastrofik (nr analizes 3.246)

Ky paragraf i referohet elementeve strukturor prej betoni dhe beton/arme, duke parashikuar nje fuge teknike ($L=1/100h$). Struktura duhet te realizohet me themele, skelete me trare, shkalle te lidhura ndermjet tyre, dhe te perfshije:

Trare themeli beton/arme realizuar me beton m-200 me dozature per m³ sipas pikes 3.1.5., te armuar ne menyre te rregullt (hekur betoni mesatarisht 300kg/m³) sipas udhezimeve ne vizatime, me beton (marka te hedhur ne shtrese te holla dhe te vibruara mire, me dimensione dhe forma sipas fleteve perkatese te vizatimeve, duke perfshire kallepet, perforcimin, skelen, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte.

A.5. Punime hekuri

A.5.1. FV hekur betoni periodic $\varnothing > 12$ mm shkarkuesi katastrofik

Ky paragraph i referohet elementeve strukturor qe ndodhet ne bjeftin e siperm te diges nga niveli fundor me uje deri ne nivelin e shkarkuesit katastrofik te diges ne te cilen perfshihet ngarkimi, blerja, transporti deri ne kantier, shkarkimi armimi sipas skicave te projektit per 1ton

A.6. Punime jashte liste

A.6.1 Shtresë kalldrëmi 20-25 cm mbi shtresën e cakellit

Ky paragraph i referohet bjeftit te siperm te diges per mbrojtjen nga gerryerja ne te cilen perfshihet blerja, ngarkimi, transporti deri ne kantier, shkarkimi vendosja me punetore e ketij kalldrimit per 1m2

A6.2 Shblokim i kanalit fundor te diges nga aluvionet (nga vepra e hyrjes bjefti i siperm ne dalje, bjefti i poshtem) me makineri.

Perfshihen punimet per transportin e makinerise ne kantier per gatitjen dhe pastrimin e tubacionit pa demtuar ate per 1ml dhe zevendesimi i pjeseve te demtuara para dhe gjate pastrimit te shkarkuesit fundor .

A6.3 Rehabilitim i sipefaqes mjedisore te demtuara dhe kthimi ne gjendjen e meparshme

Perfshihen punimet per transportin e dhe rehabilitimin e siperfaqeve te demtuara rigjenerimin dhe mbushjen e tyre me material rrethanor gjate zbatimit te punimeve per 1m2

